



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE E RINISË

Nr. 3853 Prot.
datë 14/07 2015

MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 5316 Prot.
datë 14/07 2015

URDHËR

Nr. 270, datë 14.07 2015

PËR

STRUKTURËN E VITIT SHKOLLOR 2015 – 2016

NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26, germa “ç” e pikës 2 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8872, datë 29.03.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

URDHËROJMË:

1. Struktura e vitit shkollor 2015 – 2016, në sistemin arsimor parauniversitar do të jetë si më poshtë:
 - 1.1 Në arsimin bazë:
 - a. **Mësim:** Viti shkollor fillon më 14 shtator 2015 dhe mbaron më 10 qershor 2016.
 - b. **Pushime:**
Periudha e parë fillon më 25 dhjetor 2015 dhe mbaron më 3 janar 2016.
Periudha e dytë fillon më 30 mars 2016 dhe mbaron më 3 prill 2016.
 - c. **Provime:** Provimet e Lirimit zhvillohen në periudhën 11 - 30 qershor 2016.

1.2 Në arsimin e mesëm të lartë:

a. **Mësim:**

Viti shkollor fillon më 14 shtator 2015 dhe mbaron më 17 qershor 2016.

Për maturat, viti shkollor fillon më 14 shtator 2015 dhe mbaron më 3 qershor 2016.

b. **Pushime:** Fillojnë më 25 dhjetor 2015 dhe mbarojnë më 3 janar 2016.

c. **Provime:** Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 4-30 qershor 2016.

1.3 Në arsimin profesional:

a. **Mësim:** Viti shkollor fillon më 14 shtator 2015 dhe përfundon:

a.1 Më 17 qershor 2016, për nxënësit e klasave të 10-ta (për të gjitha strukturat), për nxënësit e klasave të 12-ta (për strukturën 2+2) dhe për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta (për strukturën bllok 4-vjeçare).

a.2 Më 3 qershor 2016, për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta (struktura 2+1+1) dhe për nxënësit e klasave të 11-ta (struktura 2+2).

a.3 Më 28 maj 2016, për të gjithë nxënësit maturantë.

b. **Pushime:** Fillojnë më 25 dhjetor 2015 dhe mbarojnë më 3 janar 2016.

c. **Provime:**

c.1 Provimet përfundimtare të Nivelit I dhe II zhvillohen në periudhën 5 - 17 qershor 2016.

c.2 Provimet përfundimtare të Nivelit III, zhvillohen në periudhën 28 maj - 3 qershor 2016.

c.3 Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 4 - 30 qershor 2016.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, DAR/ZA-të dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË**


Blendi KLOSI



**MINISTRI I ARSIMIT
DHE SPORTIT**


Lindita NIKOLLA

